

VENDIM
Nr. 145, datë 31.3.2000

PËR RIORGANIZIMIN E QENDRAVE STUDENTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29, pika 1, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Riorganizimin e qendrave studentore në Tiranë, për rritjen e efektivitetit dhe të kontrollit.
2. Krijimin e drejtorisë së përgjithshme të qendrave studentore në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
3. Kjo drejtori e përgjithshme të ketë në përbërjen e vet:
 - a. Ndërmarrjen e Trajtimit të Studentëve nr.1 (NTS 1);
 - b. Ndërmarrjen e konvikteve dhe të mensave nr.2, e cila riemërtohet Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve nr.2 (NTS 2);
 - c. Ndërmarrjen tregtare të trajtimit të studentëve, nr.3, e cila riemërtohet Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve nr.3 (NTS 3);
 - ç. Ndërmarrjen e elektrik-ujësjellësit të mjediseve studentore (NEUMS);
 - d. Kinoklubin e qytetit Studenti;
 - dh. Bibliotekën e Qytetit Studenti;
 - e. Ndërmarrjen e pastrim-gjelbërimit.
4. Ndërmarrjet e mësipërme, në përbërje të drejtorisë së përgjithshme të qendrave studentore, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në konvikte e mensa, për pastrim gjelbërimin dhe për ngrohjen e mjediseve studentore.
5. Për realizimin e funksioneve dhe detyrimeve, të përcaktuara në këtë vendim, në planin e buxhetit të vitit 2000, të bëhen pakësimet e mëposhtme nga ministritë si vijon, dhe të shtohen në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës:

Ministrisë së Punëve Publike

Fond page	13 850 mijë lekë
Sigurime shoqërore	4 035 mijë lekë
Numri i punonjësve	112

Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Fond page	670 mijë lekë
Sigurime shoqërore	195 mijë lekë
Numri i punonjësve	7

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

7. Pika 1,2,5 dhe 6, të vendimit nr.214, datë 15.7.1991, të Këshillit të Ministrave, “Për shkëputjen e veprimtarisë jetësore të studentëve nga drejtimi i shkollave të larta” dhe vendimi nr.395, datë 12.8.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e qendrave studentore” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta